



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.654/2019

Gjykata Themelore ne Mitrovice - Departamenti i përgjithshëm Gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit S.C.1 nga ..., me vendbanim ne për shkak te veprës penale: Vjedhje e rende nga neni 327 par 1 nën par. 1.1 te KPRK-se, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovice PP.II.nr:838/2015 te datës 09.06.2017 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 07.06.2019, ne mungesë të prokurorit, e në prezencë te të pandehurit ne te njëjtën dite, publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.06.2019, përpiloi ketë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S.C.1 nga i ati B., e ëma Z. ,e gjinisë R., i lindur me dt. ... ne ...,tani me banim ne fshatin ...-...,i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

JANE FAJTOR

SEPSE: Me datën 05.01.2014 ne ore te pa caktuar, ne fsh. ...-... saktësisht ne vendin e quajtur “...” ne depo prone e te dëmtuarit M.M, me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te pasurisë te pandehurit fillimisht kan hapur nje vrime ne tavanin e depos ,pastaj i pandehuri S.1 hyn ne depo kurse i pandehuri S.2 mbetet ne tavanin e depos ,nëpërmes se cilës vrime te njëjtit marrin sendet: “Desert Vitanova molle” 18 paketime, çokolade për zirje 4 paketime, çokolatë “Cica Maca” 17 paketime, çokolata “Kidi” 15 paketime ,”çips” 32 copa “Kinder çokolata” 20 paketime 20 x20 gr, “Kinder çokolata” 4 paketime 10x100, napolitanka 2 paketa dhe shtrudlla 3 paketa , nga ky veprim te dëmtuarit i shkaktohet dem ne vlere prej 500 euro.

Me këtë kane kryer veprën penale- **Vjedhje e rende nga neni 327 par 1 nen par. 1.1 te KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,45,46,73, dhe 327 par. 1 nen par. 1.1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës.

GJYKON

Te pandehurin S.C.1 ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJE PREJ 1 (një) viti, si dhe me DENIM ME GJOBË ne shumë prej 300 (treqind euro) te cilat dënime do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e cekur, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK –ës deri zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro (njëzet) euro për një ditë të kaluar me burg

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale- paushallin gjyqësor shumen prej 10 euro, për fondin e kompensimit te viktimave te krimin shumen prej 30 euro, te gjitha këto janë te obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Te dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice - ka ngritur aktakuze PP.II.nr.838/2015 te datës 09.06.2017, kundër të pandehurve S.C.1 dhe S.C.2 nga ..., për shkak te veprës penale: Vjedhje e rend nga neni 327 par.1 nen par.1.1 të KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.07.06.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri S.C.2 nuk e ka pranuar fajësinë dhe për ketë te pandehur gjykata ka vazhduar ne procedure te mëtejme për shqyrtimin e çështjes, ndërsa i pandehuri S.C.1, ne ketë seancë ka pranuar fajësinë për veprën penale qe ngarkohet sipas aktakuzës, dhe nen këto rrethana pas marrjes se pëlqimit per veqimin e procedurës nga ana e prokurorit te shtetit ku i njëjti e ka dhëne pëlqimin qe te veqohet proceduar penale ndaj te pandehurit pasi qe është ne interes te drejtësisë dhe efikasitetit te procedurës, gjykata e ka veçuar procedurën penale ndaj këtij te pandehuri me aktvendim te datës 07.06.2019, i pandehuri S.C.1 lidhur me fajësinë ka deklaruar: e ndjej veten fajtor për veprën penale e cila me vihet ne barre, dhe njëkohësisht me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, dhe i premtoj gjykatës se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te njëjta penale.

Prokurori lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: Pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit S.C.1 mbështetet ne provat materiale nga te cilat prova është ngritur edhe aktakuza PP.II.nr 838/15 pranim ky i bere ne mënyre vullnetare, dhe pa kurrfarë presioni nga ana e te pandehurit, dhe atë pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me favoret dhe disfavoret e qe kane te bëjnë lidhur me pranimin e fajësisë andaj nga kjo qe u theksua i propozoj gjykatës qe ta beje pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit S.C.1.

Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që te pandehurit kuptuan natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë te pandehurit e bënë në mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të beje vlerësimin e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga te pandehurit është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, e që konkretisht mbështetet në provat materiale si: Raporti i policor me nr. rastit ..., raportet policore që gjenden në lende, deklaratat e te dëmtuarit, deklaratat e te pandehurve, lista e gjerave të kthyera e datës 06.01.2014 dhe 09.01.2014, lista e gjerave të konfiskuara e datës 09.01.2014 si dhe shkresat tjera të lendes. të gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes së akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin të fajësisë nga ana e te pandehurit, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke u bazuar në nenin 73 të KPRK-se, ashtu që kjo gjykatë patë parasysh lartësinë e dënimit për këtë veprë penale, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale për te pandehurin gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje direkte e që është shkalla më e lartë e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që në këtë rast është pasuria, e që kjo veprë penale ka qëllim të mbrojtë të mirën materiale-pasurin, rrethanat dhe mënyra më të cilat është kryer vepra penale, po ashtu gjykata ka pasur parasysh edhe faktin se këto vepra penale janë në rritje permanente si dhe që për te njëjtin zhvillohet një tjetër procedurë penale. Gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga te pandehurit e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimin të fajësisë rezulton se e ndien vetën fajtor dhe i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ky deklarim i tillë i të pandehurve për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tyre për veprën penale.

Nga gjitha këto gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurve pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton se me shqiptimin e këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit që te parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe kompensimin e viktimave për humbjen ose dëmin e shkaktuar nga vepra penale, si dhe njëkohësisht të bëjë ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që të obligoj te pandehurit që te paguajë shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej

10(dhjetë)euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te kriminit shumen prej nga 30(tridhjetë) euro te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguajnë ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarin e ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.654/2019 dt.27.06.2019

Procesmbajtësja:
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari:
Gezim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine- nëpërmes kësaj gjykate.